

KUVENDI

NR. 644 DATE 25.02.21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot .

Tiranë, më ____ .2021

Lënda : Depozitim projektligji

Drejtuar:

**Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z.Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin "PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR".

DEPUTETI PROPOZUES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 244 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 244

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, deri në vlerën deri në 50,000 Lek ose ekuivalencën në monedhë të huaj, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në 1 vit.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50,000 lek, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet.”

Neni 2

Neni 245/1 ndryshohet si më poshtë:

Neni 245/1

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, deri në vlerën deri në 50,000 Lek ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete

ose për persona të tjerë, personit që premtion ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në 1 vit.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt, është mbi vlerën 50,000 lek, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, deri në vlerën deri në 50,000 Lek ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt, është mbi vlerën 50,000 lek, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga 2 deri në 4 vjet.

Neni 3

Neni 258 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 258

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800,000 lek ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim gjer në 1 vit.

Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800,000 lek, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.”

Neni 4

Neni 259 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 259

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, deri në vlerën deri në 50,000 Lek ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt, ose premtimi i një përfitimi të tillë, është mbi vlerën 50,000 lek, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi me datë 1 qershor 2021.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI

[Shqiptaria.com]